



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



01Nr 112/02-14888
Dt: 23.09.2024

Kryetari i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 22 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, si dhe nenit 44 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, duke vendosur lidhur me formimin e komisionit për mbikëqyrjen e kontratës, me datë 13.09.2024 merr këtë:

V E N D I M

1. Formohet komisioni për mbikëqyrjen e kontratës për shfrytëzimin e pronës komunale, me numër – 01-353/01-14741, në këtë përbërje:
 1. Naim Laha – Kryesues i komisionit
 2. Jetmira Gllogjani Vula – anëtare
 3. Robert Marjakaj – anëtar
2. Komisioni i përshkruar si në pikën e parë të këtij vendimi, ka për detyrë dhe përgjegjësi që të ndërmer veprime konform legjislacionit në fuqi si vijon:
 - Të mbikëqyr realizmin e kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.
 - Të përgatitë raporte të rregullta gjashtë (6) mujore të monitorimit, realizimit të kontratës dhe ta dorëzojë në zyrën e Kryetarit.
 - Në rast të evidentimit të shkeljes së kontratës apo shmangies nga qëllimi i shfrytëzimit të pronës së paluajtshme të komunës nga shfrytëzuesi, komisioni obligohet që në çdo kohë të njoftoj kryetarin e Komunës me shkrim, së bashku me rekomandimin e tij për shkëputje të kontratës apo masat tjera të përcaktuara në kontratë.
 - Të bëj faturimin për çdo muaj dhe të njoftoj shfrytëzuesin për pagesë sipas kontratës.
 - Komisioni duhet të bëj dorëzimin -pranimi e pronës komunale, më së largu 10 ditë nga dita e nënshkrimit të kontratës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit të Komunës
- Anëtarëve të Komisionit
- Arkivit.

Ardian Gjini
për
Kryetar i Komunës së Gjakovës

